

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË



**Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë**

**DORACAK PËR STUDENTË**

Mitrovicë,

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

Përmbajtja:

|   |    |
|---|----|
| Lista e programeve të studimit të akredituara nga KSHC/AKA, të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë – sipas fakulteteve..... | 4  |
| Misioni .....   | 6  |
| UIBM.....   | 6  |
| Viti akademik.....  | 6  |
| Studimet Bachelor .....   | 7  |
| Studimet Master.....  | 7  |
| Kush ka të drejtë të studioj në UIBM.....   | 8  |
| Studimet Bachelor: .....  | 8  |
| Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente.....  | 8  |
| Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin .....  | 9  |
| Studimet Master.....  | 9  |
| Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente.....  | 10 |
| Kandidatët e pranuar për regjistrim paraqesin .....   | 10 |
| Studentët - statusi, të drejtat dhe përgjegjësitë.....  | 10 |
| Mënyrat e studimit .....  | 11 |
| Të drejtat e studentëve.....  | 11 |
| Obligimet e studentëve.....   | 12 |
| Regjistrimi në vitin vijues të studimeve .....  | 12 |
| Humbja e statusit të studentit.....   | 12 |
| Statusi i studentit të rregullt .....   | 13 |
| Riregjistrimi .....   | 14 |
| Përrjashtimi i studentëve .....   | 14 |
| E drejta për mjete juridike.....  | 14 |
| Përcaktimi i suksesit akademik.....   | 15 |
| 1. Për përcaktimin e suksesit akademik duhet të aplikohen këto metoda të vlerësimit .....   | 15 |
| 1.1. provimi;.....  | 15 |
| 1.2. kolokuiumi; .....  | 15 |
| 1.3. punim seminari; .....  | 15 |
| 1.4. praktika profesionale;.....  | 15 |
| 1.5. testi praktik gjatë ushtrimeve;.....   | 15 |
| 1.6. interpretimi dhe prezantimi i punëve të tjera. ....  | 15 |

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

|  |    |
|--|----|
| Mënyra e mbajtjes së provimit.....   | 16 |
| Vlerësimi i studentëve .....   | 16 |
| Afatet e provimeve .....   | 17 |
| Paraqitja dhe orari i provimeve.....   | 17 |
| E drejta për mjete juridike.....   | 18 |
| Riprovimi.....   | 18 |
| Programi i lëndës – syllabusi.....   | 19 |
| Ndërrimi i drejtimit të studimeve.....   | 20 |
| Procedura e ndërrimit të programit të studimit brenda Universitetit.....         | 20 |
| Procedura e ndërrimit të programit të studimit prej universiteteve të tjera..... | 21 |
| Periudha e diplomimit .....  | 21 |
| Punimi i diplomës për bachelor.....  | 21 |
| Punimi i tezës për master.....   | 22 |
| Procedurat disiplinore të studenteve .....                                       | 22 |
| Studenteve për shkeljet disiplinore mund t'ju shqiptohen këto masa:.....         | 23 |
| Përfaqësimi i studentëve në organet e Universitetit .....                        | 24 |
| Puna e Parlamentit të studentëve fokusohet në këto tema .....                    | 25 |
| Puna e Këshillit të studentëve fokusohet në këto tema .....                      | 25 |
| Sistemi për Menaxhimin Universitar (SMU).....                                    | 26 |
| Bordi Këshillëdhënës .....   | 26 |
| Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë .....                                     | 27 |
| Asociacioni “Alumni” .....   | 27 |
| Qendra për Zhvillim të Karrierës .....   | 27 |
| Këndi i rekreacioni për studentë .....   | 28 |

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

Lista e programeve të studimit të akredituara nga KSHC/AKA, të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë – sipas fakulteteve

| Fakulteti i Gjeoshkencave          | Programi i studimeve  | Niveli i studimeve | I akredituar prej | I akredituar deri më | Kohëzgjatja e studimeve | ECTS – kreditë |
|------------------------------------|---|--------------------|-------------------|----------------------|-------------------------|----------------|
| 1.                                 | Xehetari  | BSc                | 1 tetor 2022      | 30 shtator 2025      | 3 (tri) vjet            | 180 ECTS       |
| 2.                                 | Xehetari  | MSc                | 1 tetor 2022      | 30 shtator 2025      | 2 (dy) vjet             | 120 ECTS       |
| 3.                                 | Gjeologji   | BSc                | 1 tetor 2021      | 30 shtator 2024      | 3 (tri) vjet            | 180 ECTS       |
| 4.                                 | Hidrogjeologji dhe Gjeologji Inxhinierike                                   | MSc                | 1 tetor 2021      | 30 shtator 2024      | 2 (dy) vjet             | 120 ECTS       |
| 5.                                 | Vendburimet minerale  | MSc                | 1 tetor 2022      | 30 shtator 2025      | 2 (dy) vjet             | 120 ECTS       |
| 6.                                 | Materiale dhe Metalurgji (me specializime: Materiale; Metalurgji)           | BSc                | 1 tetor 2021      | 30 shtator 2024      | 3 (tri) vjet            | 180 ECTS       |
| 7.                                 | Materiale dhe Metalurgji (me specializime: Materiale; Metalurgji)           | MSc                | 1 tetor 2021      | 30 shtator 2024      | 2 (dy) vjet             | 120 ECTS       |
| Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore |   |                    |                   |                      |                         |                |
| 1.                                 | Teknologji<br>(me specializime: Inxhinieri Mjedisore dhe Inxhinieri Kimike) | BSc                | 1 tetor 2022      | 30 shtator 2025      | 3 (tri) vjet            | 180 ECTS       |
| 2.                                 | Teknologji<br>(me specializime: Inxhinieri e mbrojtjes Mjedisore )          | MSc                | 1 tetor 2022      | 30 shtator 2025      | 2 (dy) vjet             | 120 ECTS       |

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

|   |  |     |                 |                    |                |          |
|---|--|-----|-----------------|--------------------|----------------|----------|
| 3.  | Inxhinieri dhe<br>Teknologji<br>Ushqimore  | BSc | 1 tetor<br>2022 | 30 shtator<br>2025 | 3 (tri) vjet   | 180 ECTS |
| Fakulteti i<br>Inxhinierisë<br>Mekanike dhe<br>Kompjuterike |  |     |                 |                    |                |          |
| 1.  | Shkencat<br>Kompjuterike dhe<br>inxhinieri   | BSc | 1 tetor<br>2021 | 30 shtator<br>2024 | 3 (tri) vjet   | 180 ECTS |
| 2.  | Inxhinieri<br>Ekonomike  | BSc | 1 tetor<br>2021 | 30 shtator<br>2024 | 3 (tri) vjet   | 180 ECTS |
| 3.  | Makineri<br>Prodhuese  | BSc | 1 tetor<br>2021 | 30 shtator<br>2024 | 3 (tri) vjet   | 180 ECTS |
| Fakulteti<br>Juridik  |  |     |                 |                    |                |          |
| 1.  | Juridik  | LLB | 1 tetor<br>2021 | 30 shtator<br>2024 | 4 (katër) vjet | 240 ECTS |
| Fakulteti<br>Ekonomik                                       |  |     |                 |                    |                |          |
| 1.  | Biznes dhe Menaxhment<br>me specializim në<br>Banka, Financa dhe<br>Kontabilitet<br>Menaxhment dhe<br>ndërrmarrësi | BA  | 1 tetor<br>2022 | 30 shtator<br>2025 | 3 (tri) vjet   | 180 ECTS |
| Fakulteti i<br>Edukimit                                     |  |     |                 |                    |                |          |
| 1.  | Arsimi Fillor  | BA  | 1 tetor<br>2021 | 30 shtator<br>2024 | 4 (katër) vjet | 240 ECTS |

## Misioni

Misioni i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë është që të ofrojë mësimdhënie cilësore për përgatitjen e kuadrove në fusha unike për Kosovën dhe rajonin, i dedikuar të ofrojë kërkime shkencore, këshillime profesionale dhe veprimtari të tjera profesionale, që sigurojnë mirëqenie dhe avancim shoqëror

## UIBM

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë (UIBM), ka krijuar mundësi të mëdha për të rinjtë e rajonit, të cilët duke u bërë pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë në Kosovë, njëkohësisht të bëhen pjesë e tregut të punës. Në UIBM janë të akredituara 20 programe, të cilat janë mjaft atraktive dhe të kërkuara jo vetëm brenda, por edhe jashtë vendit.

## Viti akademik

1. Universiteti organizon studimet në pajtim me programet ekzistuese të studimit gjatë vitit akademik, i cili zgjat dymbëdhjetë (12) muaj. Viti akademik fillon më 1 tetor dhe mbaron më 30 shtator.
2. Periudha aktive e studimeve (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokuiumet) është e ndarë në dy semestra: semestri dimëror që fillon më 1 tetor dhe mbaron më 15 janar dhe semestri veror që fillon më 16 shkurt dhe mbaron më 31 maj.
3. Lënda mund të ligjërohet me javë (15 javë semestri), gjatë një apo dy (2) semestrave ose mund të mbahet si bllok ligjëratash në një (1) semestër.
4. Ligjëratat mund të zhvillohen në formë fizike në universitet, në formë të mësimin online dhe në formë të kombinuar. Kalendarin e studimeve nxirret nga Senati më së voni deri më 30 gusht dhe përmban orarin e ligjëratave (ligjëratat, ushtrimet, seminarët, kolokuiumet), kushtet dhe afatet e provimit për vitin akademik.

### Studimet Bachelor

1. Studimet bachelor zgjasin 3 ose 4 vjet dhe kërkojnë 180 respektivisht 240 pikë të ECTS-së, nëse nuk përcaktohet ndryshe me rregulloret përkatëse të Ministrisë.
2. Senati nxjerr rregullore të veçanta për studimet themelore në fusha të caktuara me propozimin e këshillit të fakultetit përkatës nëse këto programe parashihet të zgjasin deri në 6 vjet dhe kërkojnë deri në 360 pikë të ECTS-së.
3. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve bachelor fitohet thirrja akademike bachelor i shkencës apo bachelor i arteve.

### Studimet Master

1. Studimet master zgjasin 1 respektivisht 2 vjet dhe kërkojnë 60 respektivisht 120 pikë të ECTS-së, nëse nuk përcaktohet ndryshe me rregulloret përkatëse të Ministrisë.
2. Përfundimi me sukses i studimeve themelore – bachelor është kusht për regjistrimin e studimeve master.
3. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve master fitohet thirrja akademike master i shkencës, master i arteve apo master profesional.

## Kush ka të drejtë të studioj në UIBM

### Studimet Bachelor:

1. Secili kandidat që e kalon testin e maturës e ka të drejtën për të konkurruar për studime në UIBM sipas legjislacionit në fuqi.
2. Kushtet për pranim në studimet themelore – bachelor në Universitet janë:
  - 2.1. përfundimi me sukses i shkollës së mesme në Kosovë, i vërtetuar me diplomë;
  - 2.2. përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku dymbëdhjetë (12) vjet të shkollimit të vërtetuar me diplomë përkatëse;
  - 2.3. përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku dymbëdhjetë (12) vjet të shkollimit vërtetuar me diplomë përkatëse, të fituar në botën e jashtme, në qoftë se është bërë barasvlerësimi me diplomën e maturës. Vendimi për njohjen e diplomës dhe barasvlerën merret nga MASH – i.
3. Senati nxjerr rregullore, të cilat përcaktojnë në hollësi kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore – bachelor.
4. Për fusha të veçanta studimi, Universiteti organizon provime shtesë - provim pranues për disa lëndë, në procedurën e pranimit të studentëve, të cilat duhet të aprovohen nga MASHT – i. Në këtë rast, studenti duhet ta kalojë me sukses provimin pranues për regjistrim në vitin e parë të studimeve. Pranimi në studimet ma

### Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

1. Certifikatën e lindjes (origjinal)
2. Kopjen e letërnjoftimit
3. Dëshmi – Vendimi nga organi kompetent, mbi njohjen e statusit të familjes së dëshmorit,
4. Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal ose të noterizuara)
5. Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal ose të noterizuar)
6. Vërtetimin mbi pikët e fituara në provimin e maturës për lëndët mësimore (vetëm kandidatët për fakultetet: Fakulteti i Gjeoshkencave, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike)



Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

7. Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: umib.net (apliko online)
8. Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit të Mitrovicës, ndërsa pagesa bëhet në bankë.
9. Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.

### Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin

1. Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit dhe fotografimit për ID.
2. Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin e Mitrovicës, vitin e parë të studimeve e kanë falas. Pagesa për një semestër për studentë që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, do të jetë në lartësi prej 25 € për studime të rregullta.

### Studimet Master

#### Pranimi në studimet master

1. Studentët në studime master pranohen mbi bazën e konkurrimit, sipas rezultateve të studimeve paraprake dhe ekuivalencës së tyre, sikurse përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë.
2. Studentet të cilët kanë përfunduar studimet paraprake lejohen të hyjnë në konkurrencë të barabartë për pranim në studime Master apo doktoratë nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.
3. Kriteret e posaçme për pranim në studimet master caktohen nga Senati, në përputhje me dispozitat e Statuti.
4. Për programet e përbashkëta studimore kriteret për pranim caktohen nga senatet e universiteteve partnere, në përputhje me dispozitat e statuteve të tyre

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

1. Certifikata apo ekstrakti i lindjes (original);
2. Kopja e letërnjoftimit;
3. Diploma – certifikata e diplomimit origjinal e studimeve themelore – bachelor, ose kopja e noterizuar sipas origjinalit;
4. Dëshmia e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë (për kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit dhe në kolegjet private të Republikës së Kosovës);
5. Pasqyra e provimeve të dhëna me notë mesatare, (vetëm për kandidatët nga programe dhe fakultete të tjera);
6. Pagesa për aplikim në lartësi të përcaktuar sipas UA të MASHT-it. (Forma e pagesës shkarkohet nga ueb-faqja e UMIB-it);
7. Vendimi mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit;
8. Dokumenti nën pikën 2.3. mund të pranohet duplikat vetëm nëse dëshmohet me vërtetim të organeve kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj.
9. Fletëparaqitja e plotësuar e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (Linku për aplikim Online përmes Internetit është: [umib.net](http://umib.net))
10. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me rregulloren për studimet master të UMIB dhe rregulloreve përkatëse të njësive akademike.

#### Kandidatët e pranuar për regjistrim paraqesin

1. Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit dhe fotografimit për ID.
2. Fletëpagesën në lartësi prej 150 € për një semestër.

#### Studentët - statusi, të drejtat dhe përgjegjësitë

1. Personi i regjistruar në UIBM e ka statusin e studentit.
2. Statusi i studentit vërtetohet me ID kartën e studentit.

## Mënyrat e studimit

1. Universiteti ofron dy (2) mënyra të studimit:
  - 1.1. studime të rregullta;
  - 1.2. studime me korrespondencë.
2. Studenti mund të ketë statusin e:
  - 2.1. studentit të rregullt;
  - 2.2. studentit me korrespondencë;
  - 2.3. studentit mysafir.

## Të drejtat e studentëve

1. Studentët që janë të pranuar në Universitet kanë të drejtë:
  - 1.1. të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminarët dhe në mësimet e organizuara në lëndët e programit të zgjedhur të studimit sipas mbarëvajtjes së studimeve;
  - 1.2. të shfrytëzojnë bibliotekat universitare dhe shërbimet e tjera për studentë;
  - 1.3. të marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit studentë në organet universitare, të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve, ku janë të caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe në mënyrë të singertë. Në rast të konfliktit të interesit në lidhje me përmbajtjen, anëtarët e deleguar të studentëve nuk marrin pjesë në takime të organeve qeverisëse të Universitetit;
  - 1.4. për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga Universiteti;
  - 1.5. të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e universitetit;

1.6. për të kundërshtuar një vendim apo një veprim të Universitetit ndaj tyre në MASHT dhe në gjykatën kompetente

### Obligimet e studentëve

1. Studentët që janë të pranuar në Universitet kanë obligim:
  - 1.1. t'i respektojnë rregulloret e lëshuara nga Universiteti;
  - 1.2. t'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
  - 1.3. t'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
  - 1.4. të vijojnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve;
  - 1.5. të sillen mirë si në mjediset e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskredituar Universitetin;
  - 1.6. të respektojnë rregullat e kodit etik;
  - 1.7. të paguajnë pagesa dhe tarifa që janë të caktuara.

### Regjistrimi në vitin vijues të studimeve

1. Përfundimi me sukses i vitit në pajtim me programin e studimit është parakusht që studentin të regjistrohet në vitin tjetër.
  2. Studenti i cili nuk ka mundur të përfundojë me sukses vitin duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve.
  3. Numri maksimal i viteve të regjistruara sërish është i barabartë me numrin e viteve të rregullta të studimit përkatës.

### Humbja e statusit të studentit

1. Studenti i rregullt humb statusin për këto arsye:
  - 1.1. kur vendos të largohet nga studimet;
  - 1.2. kur i ka përfunduar studimet;
  - 1.3. kur dështon të regjistrohet në vitin akademik;

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

- 1.4. kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve;
- 1.5. kur arrin numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet.
- 1.6. në rastin e përjashtimit, në bazë të vendimit të nxjerrë pas procedurës disiplinore.
2. Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për një (1) apo dy (2) vite. Vendimin e merr Këshilli i njësisë akademike. Në rast se merret vendim pozitiv studentin do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.
3. Këshilli i njësisë akademike zbaton rregullat e posaçme për mbajtjen e statusit të studentit të rregullt në këto raste:
  - 3.1. për të arriturat e veçanta në fushën e sportit, vërtetuar me status amator apo profesional në nivel rajonal apo më lart;
  - 3.2. për të arriturat e veçanta si krijues artistik i njohur, vërtetuar me reagimin relevant të mediave dhe konfirmuar nga Këshilli i Fakultetit përkatës.
  - 3.3. për individët me aftësi të kufizuar fizike, duke përfshirë edhe aftësitë e kufizuara të të paritë dhe të dëgjuarit, apo mendore, vërtetuar me certifikatë të mjekut.
4. Vendimi për regjistrim merret për çdo vit nga Këshilli i njësisë akademike.
5. Studenti mund të kërkojë suspendim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet e dëshmuara si të:
  - 5.1. sëmundjes së rëndë;
  - 5.2. kujdesit për fëmijët nën moshën trivjeçare;
  - 5.3. shtatzënisë dhe lehonisë;
  - 5.4. raste të tjera të justifikuara.
6. Vendimin përfundimtar e merr dekani i njësisë akademike

### Statusi i studentit të rregullt

1. Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy (2) vjetësh pasi të jenë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe studentin duhet të japë provimin e diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet.
2. Studenti që e ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën mund të paraqesë kërkesë te dekani i njësisë akademike për zgjatjen e kësaj periudhe edhe për një (1)

## Riregjistrimi

1. Studenti mund të regjistrohet sërish si student i rregullt, pa ndonjë pengesë, në lidhje me periudhën e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt, në bazë të këtij Statuti. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt, në bazë të këtij Statuti, nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.
2. Në qoftë se planprogrami valid në kohën e regjistrimit të parë të studentit nuk zhvillohet në vitin vijues të regjistrimit të studentit pas suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij Statuti, komisioni i studimeve i njësisë akademike vendos për provimet diferenciale ose për obligimet e tjera shtesë si kusht për vazhdimin e studimeve

## Përgjashtimi i studentëve

1. Këshilli i njësisë akademike i përjashton nga Universiteti përgjithmonë ose përkohësisht studentët që i shkelin rëndë rregullat. Studentët e akuzuar për shkelje kanë të drejtë të dëgjohen nga Komisioni disiplinor, i cili e këshillon Këshillin e njësisë akademike. Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Komisionit të ankesave në nivel të njësisë akademike si shkallë e dytë.
2. Rregulloret që i elaborojnë këto procedura nxirren nga Këshilli Drejtues pasi të jenë konsultuar me Parlamentin e Studentëve.

## E drejta për mjete juridike

1. Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të njësisë akademike dhe njësisë organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.
  2. Ankesat e tilla i dorëzohen komisionit të studimeve të njësisë akademike brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

3. Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë 58 këshillit të njësisë akademike, brenda tridhjetë (30) ditëve të punës pas pranimit të ankesës.
4. Ankesa rreth vendimit në shkallë të dytë vendoset nga Senati.
5. Studentët kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin e Senatit në gjykatën kompetente.

## Përcaktimi i suksesit akademik

1. Për përcaktimin e suksesit akademik duhet të aplikohen këto metoda të vlerësimit:

1.1. provimi;

1.2. kolokuiumi;

1.3. punim seminar;

1.4. praktika profesionale;

1.5. testi praktik gjatë ushtrimeve;

1.6. interpretimi dhe prezantimi i punëve të tjera.

## Mënyra e mbajtjes së provimit

1. Provimet shërbejnë si mënyrë e rregullt e vlerësimit të dijes.
2. Provimet organizohen veç e veç për çdo lëndë ose kombinohen për më shumë lëndë në pajtim me programin e studimeve (provim me komision).
3. Provimet mbahen në njërin nga këto mënyra, sipas diskrecionit të mësimdhënësve, nëse nuk ka vendim tjetër nga këshilli i fakultetit:
  - 3.1. me shkrim;
  - 3.2. me gojë;
  - 3.3. me shkrim dhe me gojë;
  - 3.4. punë praktike.
4. Te provimet e kombinuara me gojë dhe me shkrim diferenca kohore nuk mund të jetë më e gjatë se shtatë (7) ditë.
5. Provimet vlerësohen nga një pyetës ose nga një komision për provime.
6. Provimet mund të mbahen nga një komision për provime nëse:
  - 6.1. studenti është ankuar;
  - 6.2. është caktuar me programin e studimeve.
7. Procedura e mbajtjes së provimit është e përcaktuar me programin e studimit.
8. Mënyra e përcaktimit të dijes dhe të dhënies së provimit do të përcaktohet me programin mësimor të lëndës – syllabus.

## Vlerësimi i studentëve

Suksesi i studentit në provim shprehet me nota prej 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë).

Provimet janë publike dhe shpallen në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e njësisë akademike përkatëse.

Ndalohej hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtar të personelit universitar ose të fakultetit, me përjashtim të shefit të departamentit të Fakultetit, prodekanit për çështje mësimore dhe personave tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të kryer kontroll.

Përcaktimi i notës përfundimtare të provimit bëhet në këtë mënyrë:



Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

| Pikët    | Nota | Përshkrimi   | ECTS Nota |
|----------|------|--------------|-----------|
| 91 – 100 | 10   | Shkëlqyeshëm | A         |
| 81 – 90  | 9    | Shumë mirë   | B         |
| 71 – 80  | 8    | Mirë         | C         |
| 61 – 70  | 7    | Kënaqshëm    | D         |
| 51 - 60  | 6    | Mjaftueshëm  | E         |
| 0 - 50   | 5    | Dobët        | FX/F      |

Studenti konsiderohet se ka kaluar me sukses provimin kur vlerësohet nga nota 6 deri në 10, ndërsa konsiderohet se nuk e ka kaluar provimin nëse është vlerësuar me notën 5.

### Afatet e provimeve

1. Provimet për studimet bachelor dhe master mbahen gjatë afatit të provimeve.
2. Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit). Periudha e saktë për çdo afat është e përcaktuar me kalendarin e përgjithshëm të studimeve, i cili është i pranuar nga Senati dhe i hapur për publikun.
3. Oraret e afateve të provimeve, ku janë të përfshira oraret ditore, shpallen në fillim të vitit akademik.
4. Oraret e provimeve do të përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një (1) provim në ditë.
5. Oraret e provimeve, pasi të jenë shpallur, janë detyruese, si për pyetësin, ashtu edhe për studentin

### Paraqitja dhe orari i provimeve

1. Koha e paraqitjes së provimit do të fillojë katër (4) javë deri në tetë (8) ditë para afatit të provimeve.
2. Orari i provimit shpallet jo më vonë se tetë (8) ditë para fillimit të afatit të provimeve.
3. Në rastet kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, provimi konsiderohet që ka dështuar (është notuar me pesë (5)). Përrjashtimisht, në rastet e mungesës së studentit për një arsye të cilën e ka njoftuar fakultetin konsiderohet se ka abstenuar dhe nuk notohet.

4. Me kërkesë të tij, studentit mund t'i lejohet nga dekani i njësisë akademike që të hyjë më herët në provim apo më vonë, po që se merr pjesë në një program ndërkombëtar për shkëmbim të studimeve ose është duke bërë mësimin praktik jashtë vendit, gjatë periudhës së caktuar për provim.

### E drejta për mjete juridike

1. Studenti ka të drejtë të parashtojë ankesë me shkrim dekanit të njësisë akademike kundër notës së marrë. Ankesa duhet të parashtrohet brenda dy ditëve të punës pasi të jenë shpallur rezultatet.

2. Ankesa mund të bëhet për këto arsye:

2.1. për provimin me shkrim - parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim;

2.2. për provimin me gojë - parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë;

2.3. për provimin e kombinuar me shkrim dhe me gojë:

2.3.1. parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me shkrim, para hyrjes në provimin me gojë;

2.3.2. parashtrohet ankesë kundër notës së marrë me gojë që nënkupton se është pranuar nota nga provimi me shkrim.

3. Pas pranimit me kohë të ankesës, dekani i njësisë akademike formon komisionin e provimit brenda pesë (5) ditëve të punës, pasi të jetë pranuar ankesa dhe emëron tre (3) profesorë, por pa pyetësin kundër notës së të cilit është ankuar studenti.

4. Në rast se përsëritet provimi me gojë, vlerësimi nga komisioni bëhet në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.

5. Në rast të ankesës kundër notës në provimin me shkrim, provimi me shkrim do të rishqyrtohet nga komisioni në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.

6. Nuk mund të parashtrohet ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

7. Testet nga provimet lidhur me vlerësimin e studentëve ruhen së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes së rezultateve të provimit

### Riprovimi

1. Studenti ka të drejtë të riprovohet në lëndën të cilën nuk e ka dhënë.

2. Sipas rregullës, studenti ka të drejtë të hyjë më së shumti tri (3) herë në provimin të cilin nuk e ka dhënë.
3. Studentit pasi të ankohet, me një arsyetim të bazuar, mund t'i lejohet nga dekani i njësisë akademike që të hyjë në provim për të katërtën herë. Provimi pastaj mund të mbahet para komisionit prej tre anëtarësh, të cilët janë të emëruar nga dekani i njësisë akademike.
4. Në rast se sërish regjistrohet viti i njëjtë, nuk merret parasysh numri i mëparshëm i provimeve të dështuara të studentit.
5. Në rast se studentit sërish dështon katër (4) herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai humb statusin e studentit të rregullt në programin e caktuar të studimeve.
6. Studenti mund të rifitojë statusin e studentit, në qoftë se paraqitet në një program të ri të studimeve. Vendimi mbi rifitimim e statusit të studentit përcakton provimet dhe të tjera që i pranohen studentit dhe obligimet e studentit në programin e ri të studimeve.

### **Programi i lëndës – syllabusi**

Syll abusi është dokument i cili tregon përmbajtjen e një lënde mësimore dhe që ka qëllimin dhe elementet tjera udhëzuese për studentët, për llojin e mësimdhënies që ata mund të presin nga syll abusi. Një syll abus përmban:

- Të dhënat bazike – informacionin e përgjithshëm për lëndën mësimore;
- Përshkrimin e lëndës mësimore – kursit;
- Qëllimet e lëndës mësimore – kursit;
- Rezultatet e pritura të nxënies;
- Ngarkesën e studentit në aktivitete;
- Metodologjinë e mësimdhënies;
- Metodot e vlerësimit;
- Literatura bazë dhe literatura shtesë;
- Plani i dizajnuar i mësimimit – kalendari i lëndës mësimore, si dhe
- Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes.
- ETCS
- ECTS është sistem për transfer dhe akumulim të kredive i cili është i orientuar kah studentit dhe paraqet ngarkesën e studentit për të arritur objektivat e një programi të caktuar të studimit. Ky sistem lehtëson njohjen e periudhës së studimit në institucionet

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË  
tjera (në vend dhe jashtë), transferin e kredive të akumuluar nga një IAL në tjetrin dhe  
kështu mundëson mobilitet më të madh të studentëve.

### Ndërrimi i drejtimit të studimeve

1. Studenti mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit, duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në njësinë e njëjtë apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit.
2. Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit, me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.
3. Gjatë ndërrimit të programit të studimit studentit i lejohet të fillojë programin e ri të studimit nëse së paku pesëdhjetë për qind (50 %) e provimeve janë dhënë me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.
4. Sipas paragrafit 3. të këtij neni, studentit i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve:
  - 4.1. më së paku në vitin e dytë të studimeve ose
  - 4.2. në vitin e studimeve që vijon pas programit të vjetër të studimeve.
5. Ndërrimi i programit të studimit nuk mund të bëhet nëse studentit duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri të studimeve, në pajtim me paragrafët 3. dhe 4.

### Procedura e ndërrimit të programit të studimit brenda Universitetit

1. Studenti duhet t'ia dorëzojë kërkesën për ndërrimin e programit të studimit Komisionit për studime të njësisë akademike, ku dëshiron të vazhdojë studimet. Bashkëngjitur me kërkesën duhet të jetë evidenca për plotësimin e suksesshëm të kërkesave, bazuar në programin e mëparshëm të studimit.
2. Komisioni i studimeve i fakultetit përcakton detyrimet individuale për ndërrimin e programit të studimit në pajtim me rregullat e caktuara të programit të studimit.

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

3. Vendimi për ndërrimin e programit të studimit duhet të merret nga Këshilli i njësisë akademike me propozimin e komisionit të studimeve.
4. Ankesa kundër vendimit mbi refuzimin e ndërrimit të programit të studimit duhet t'i bëhet këshillit të njësisë akademike nga studenti, brenda tetë (8) ditëve të punës pas publikimit të vendimit.

### Procedura e ndërrimit të programit të studimit prej universiteteve të tjera

Gjatë ndërrimit të programit të studimit prej një universiteti tjetër publik në UIBM do të vlejnjë rregullat e njëjta si ato gjatë ndërrimit të programit të studimit brenda Universitetit.

### Periudha e diplomimit

1. Pas përfundimit të semestrit të fundit, të rregullt, të studimeve bachelor apo master, studentit do t'i caktohet një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajve për t'i përfunduar provimet (periudha e diplomimit).
2. Studenti mund të kërkojë një herë nga dekani i njësisë akademike për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për dymbëdhjetë (12) muaj të tjerë..

### Punimi i diplomës për bachelor

1. Programet e studimeve bachelor përfundojnë me punimin e diplomës për bachelor ose me provim para komisionit, në pajtim me programet e tyre të studimeve.
2. Punimi i diplomës për bachelor punohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore.
3. Punimi i diplomës për bachelor mund të punohet bashkë nga dy (2) ose tre (3) studentë (grup hulumtues) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat
4. Për kërkesën për punimin e diplomës për bachelor nga dy (2) ose tre (3) studentë vendos Këshilli i njësisë akademike.

5. Procedura për aplikim, punim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për bachelor përcaktohet nga këshilli akademik i njësisë akademike.
6. Para mbrojtës së punimit të diplomës, studenti nënshkruan deklaratën nën betim që punimi është origjinal, nëse vërtetohet e kundërta thirrja revokohet.

### Punimi i tezës për master

1. Programet e studimeve master përfundojnë me punimin e tezës për master, në pajtim me programet e studimeve.
2. Punimi për master punohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushat e caktuara shkencore.
3. Punimi i diplomës për master punohet nga dy (2) ose tre (3) studentë (grupi kërkimor) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
4. Aplikimi për punimin e diplomës për master nga dy (2) ose tre studentë vendoset nga Këshilli akademik i njësisë akademike.
5. Procedura për paraqitje, punim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për master përcaktohet nga Këshilli i njësisë akademike.
6. Para mbrojtës së punimit të diplomës, studenti nënshkruan deklaratën nën betim që punimi është origjinal, nëse vërtetohet e kundërta thirrja revokohet.

### Procedurat disiplinore të studenteve

Studentët janë të detyruar që t'i përmbahen dispozitave të Statutit të Universitetit dhe akteve tjera të Universitetit dhe të Fakulteteve, të respektojnë Kodin e Etik të Universitetit dhe t'i përmbahen rregullave të mirësjelljes, si dhe të ruajnë dhe të kujdesen për reputacionin e studentit, të Fakultetit dhe të Universitetit në përgjithësi. Studentet janë të obliguar t'u përmbahen obligimeve që dalin nga aktet e përgjithshme të Universitetit, gjatë kohës së hyrjes në provim dhe në kohën e mbajtjes së ligjëratave dhe ushtrimeve. Në këtë kuptim, shkelje disiplinore e studentit konsiderohet çdo tentim apo veprim i tij, të cilin e përdor për të kopjuar apo falsifikuar, për të marre dhe dhëne informata të

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

paautorizuara nga studentet e tjerë, me qëllim të plotësimit të testit apo të kollokviumit në mënyre të kundërligjshme.

Shkelje disiplinore e studentit konsiderohet secili rast i mosrespektimit të detyrimeve nga ana e studentit, Shkelje të rënda disiplinore konsiderohen posaçërisht:

- Veprimet që shkaktojnë vepër penale për të cilat parashihet ndjekje penale sipas detyrës zyrtare;
- Veprimet që shkaktojnë vepër penale që është shkaktuar ndaj mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve dhe punëtorëve tjerë të Fakultetit dhe Universitetit ose ndaj studenteve tjerë;
- Shkatërrimi ose dëmtimi me qëllim i pasurisë të Universitetit ose fondit të librave në Bibliotekë;
- Prishja e rendit dhe shkelja disiplinore lidhur me njërin prej formave të mësimit ose provimit;
- Keqpërdorimi i hapësirave, materialeve, pajisjeve të informatikës dhe pajisjeve tjera të Fakultetit;

Shkelje të rënda të rregullave të mirësjelljes ndaj mësimdhënësve, punëtorëve tjerë të Universitetit dhe Fakulteteve apo ndaj studenteve, qytetareve dhe organeve dhe organizatave tjera në objektet e fakultetit dhe të universitetit, si dhe në objekte tjera zyrtare apo vende publike tjera.

Studenteve për shkeljet disiplinore mund t'ju shqiptohen këto masa:

1. Vërejtje me shkrim,
2. Paralajmërimi i fundit para se të përjashtohet,
3. Përjashtim nga studimet deri në dy vjet,
4. Përjashtim përgjithmonë nga Fakulteti.

Masat e përjashtimit nga Fakulteti, të cekura në pikën 3 dhe 4 mund të shqiptohet vetëm për shkelje të rënde disiplinore ose në rastet e përsëritjes së shkeljeve disiplinore. Masa disiplinore nga pika 3 nënkupton ndalimin e regjistrimit të vitit dhe ndalimin e hyrjes në provime dhe pjesëmarrjes në format tjera të mësimit.

Komisioni, si shkallë e parë, e këshillon Këshillin e Fakultetit lidhur me nxjerrjen e vendimit dhe shqiptimin e masës disiplinore për shkak të shkeljes disiplinore të studentit. Këshilli i Fakultetit mund të shqiptojë masën disiplinore vetëm nëse kryesi i shkeljes është dëgjuar në seance nga Komisioni disiplinor. Përjashtimisht, masa mund të shqiptohet edhe nëse kryesi nuk është dëgjuar, ndërsa në seance nuk ka marrë pjesë edhe pse është ftuar në mënyre të rregullt.

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

Vendimi i marre në procedure disiplinore i dorëzohet studentit dhe dekanit të fakultetit. Vendimi mbi shqiptimin e masës duhet të përmbaje hyrjen, diapozitivin, arsyetimin si dhe këshillën juridike për të drejtën e animimit të vendimit nga palët.

Studentet kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marre prej Këshillit të njësive akademike. Ankesa i dorëzohet Komisionit të studimeve të njësive akademike brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.

### Përfaqësimi i studentëve në organet e Universitetit

Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilave mund t'i përkasin të gjithë studentët bachelor dhe master.

Secila organizatë studentore duhet të ketë statutin e vet që aprovohet nga anëtarët e saj dhe në pajtim me rregulloren për zgjedhjet e studentëve. Statuti do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mos diskriminim.

Interesat e studentëve do të përfaqësohen në Universitetin përmes këtyre organeve:

1. Parlamenti i studentëve në nivel të Universitetit;
2. Këshillat e studentëve në nivel të secilës njësi akademike.

Organizatave studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për parlamentin studentëve dhe këshillat e studentëve të njësive akademike në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.

Studentët të cilët kanë të përsëritur vite të studimeve nuk mund të kandidohen, përkatësisht të zgjidhen në pozita udhëheqëse studentore.

Studentët që janë pjesë e organeve drejtuese të partive politike nuk mund të kandidohen në listat zgjedhore të organizatave studentore.

Me rastin e diplomimit, kandidati mandatar nuk mund të vazhdojë të mbajë mandatin e fituar gjatë kohës sa ishte student. Mandati i mbetur vakant plotësohet me kandidatin e radhës së renditur në listën e certifikuar të kandidatëve.



### Puna e Parlamentit të studentëve fokusohet në këto tema

1. Interesat e studentëve në nivel të Universitetit;
2. Angazhimi për cilësinë në mësimdhënie dhe mësimxënie;
3. Studimet që ndërlidhen me aspekte të reformave të Universitetit dhe zhvillimet akademike;
4. Zhvillimin e cilësisë së të mësuarit dhe të vlerësimit;
5. Bursat universitare;
6. Çështjet tjera të përgjithshme të interesave akademike të studentëve;
7. Organizimin e aktiviteteve kulturore sportive.

Parlamenti i studentëve merr vendimet si në vijim: Zgjedhjen e një anëtari– student në Senatin e Universitetit; Zhvillimin e aktiviteteve studentore në kuadër të Universitetit; Propozimet për Senatin e Universitetit, në lidhje me çështjet studentore dhe akademike; Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe këshillat e Universitetit ku studentët janë anëtarë sipas Statutit.

### Puna e Këshillit të studentëve fokusohet në këto tema

1. Interesat e studentëve në nivel të njësisë akademike;
2. Studimet që ndërlidhen me aspekte të reformave të fakultetit dhe zhvillimet akademik;
3. Zhvillimi i cilësisë së mësimin dhe të vlerësimit;
4. Bursat universitare;
5. Organizimin e aktiviteteve kulturore sportive;
6. Çështjet tjera të ngjashme.

Secili këshilli i studentëve merr vendime si në vijim: Propozimin e listës për një anëtar- student të Senatit; Zgjedhjen e një anëtari – student në këshillat e fakultetit; Zhvillimet e aktiviteteve studentore në kuadër të fakultetit; Propozimet për këshillin e fakultetit lidhur me çështjet studentore dhe akademike; Pjesëmarrja në të gjitha komisionet dhe këshillat e fakultetit ku studentët janë anëtarë sipas Statutit.

## Sistemi për Menaxhimin Universitar (SMU)

Sistemi për Menaxhimin Universitar (SMU) është platformë elektronike e menaxhimit të të dhënave për shërbimin e studentëve.

SMU-ja përbëhet prej këtyre moduleve:

1. Moduli i aplikimit për regjistrimin e studentëve;
2. Moduli i notimit;
3. Moduli i pagesave studentore;
4. Moduli i ID kartelave të stafit dhe të studentëve;
5. Moduli i diplomave;
6. Moduli i sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit;
7. Moduli i kompetencave dhe përmbajtjeve mësimore;
8. Moduli i bibliotekës.
9. Module të tjera, të cilat mund të shtohen me vendime të veçanta

## Bordi Këshillëdhënës

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë (UIBM), është i hapur për bizneset me qëllim të krijimit të mundësive për rritje të bashkëpunimit dhe përfitimit të ndërsjellë. Si rrjedhojë në një takim të përbashkët më 01 prill 2019, drejtuesit e UIBM me drejtues dhe përfaqësues të bizneseve, u pajtuan për themelimin e Bordit Këshillëdhënës të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë.

Bashkëpunimi i Universitetit me bizneset ndikon në rritjen e cilësisë së kuadrove. Nëpërmjet këtij bordi bizneset do të mund të ndikojnë në zhvillimin e programeve të reja, që janë të nevojshme për ekonominë. Hapja e Universiteti për bizneset është shumë e rëndësishme, me qëllim që universitetet të zhvillohen në universitete ndërmarrëse.

Në statutin e këtij bordi, thuhet se qëllimi është lidhja e të gjitha bizneseve, për të krijuar bashkëpunim të vazhdueshëm dhe krijimin e lidhjeve në mes bizneseve dhe Universitetit.

## Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

Memorandumi i mirëkuptimit për hapjen e Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është nënshkruar më 04 prill 2019 nga rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, Alush Musaj dhe ministri për Inovacion dhe Ndërmarrësi, Besim Beqaj.

Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Universitetin “Isa Boletini”, vlerësohet me rëndësi për studentët, stafin akademik dhe biznesin dhe parqet një lajm i mirë jo vetëm për Universitetin “Isa Boletini”, por edhe për Mitrovicën dhe rajonin, meqë Qendra do të jetë në shërbim të të gjithëve. Parashihet që ajo ta shndërroj universitetin në një qendër zhvillimi për kuadrot e reja dhe për zhvillimin e biznesit.

## Asociacioni “Alumni”

Asociacioni “Alumni” i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, është themeluar më 05 maj 2019. Themelimi i këtij asociacioni vlerësohet si një moment i rëndësishëm për Universitetin. “Alumni” do të ndihmoj në lidhjen e të gjitha gjeneratave të studentëve, për të krijuar bashkëpunim të vazhdueshëm dhe krijimin e lidhjeve në mes studentëve, profesorëve të fakulteteve përkatëse dhe bashkësisë më të gjerë akademike.

Ndryshe parashihet që “Alumni” të krijojë bazën e të diplomuarve dhe të dhënat e tyre për të bërë të mundur depërtimin e tyre në tregun e punës, mandej të organizoj ngjarje, seminare, konferenca profesionale dhe të bëjë avancimin profesional të të diplomuarve.

## Qendra për Zhvillim të Karrierës

Me vendim të Këshillit Drejtues të Universitetit “Isa Boletini”, më 05 gusht 2019, është themeluar Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK), që paraqet një projekt të rëndësishëm për studentët dhe vetë Universitetin. Një qendër e tillë do të jetë një pikë e rëndësishme informacioni dhe ndërmjetësimi për studentët.

QZHK do të ndihmoj studentët e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, sa i përket zhvillimit të njohurive dhe shkathtësive që do t’u ndihmojnë për punësim, ofrimin e mundësisë për studentët që të fitojnë përvojë pune gjatë studimeve, ofrimin e informatave për tregun e punës,

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë  
DORACAK PËR STUDENTË

ofrimin e mundësisë për qasje në informata për studime, trajnime, seminare, ligjërata dhe aktivitete tjera.

Ndryshe, QZHK do të ndihmoj në zhvillimin e aftësive, njohurive dhe shkathtësive, të cilat janë kyçe për procesin e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve, do të ofroj shërbime të digjitalizuara për edukim, këshillim, zhvillim dhe orientim në karrierë etj.

### Këndi i rekreacioni për studentë

Studentët e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë kanë në dispozicion një kënd jashtëzakonisht atraktiv për rekreacion. Kjo është bërë e mundur me një grand të fituar nga IOM nga studentët. Këndi për rekreacion, gjendet në përdhesen e objektit ku janë të vendosura fakultetet. Projekti u implementua në koordinim me Parlamentin Studentor.

Më gjerësisht studentët mund të informohen nëpërmjet uebfaqes ([www.umib.net](http://www.umib.net)), ku janë të publikuara të gjitha rregulloret e Universitetit “Isa Boletini”, njoftimet, konkurset etj. Gjithashtu studentët mund të informohen edhe nëpërmjet faqes zyrtare në facebook Universiteti “Isa Boletini”. Po ashtu mund të paraqiteni në zyrat për shërbime studentore të njëjësive akademike, Gjithashtu mund të merrni përgjigje edhe nëpërmjet emailit zyrtar [info@umib.net](mailto:info@umib.net).

**Ky doracak është hartuar nga zyra për shërbime studentore e UIBM – it dhe do të shërbej si mjet lehtësues në përdorim të studentëve për të qenë i informuar dhe për të marr vendime individuale lidhur me të gjitha proceset që i përcjellin studentët gjatë studimeve. Manuali do të publikohet në ueb faqen e UMIB – it.**

Adresa:

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

Email: [info@umib.net](mailto:info@umib.net), uebi: [www.umib.net](http://www.umib.net)

Tel: 00383 (0)28 535 725